



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr.7199/1Prot

Shkodër, më 19.06.2020

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

Njësia Administrative Postribë, Shkodër
e.mail: _____

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Bashkisë Shkodër dhe regjistruar me nr.7199 prot., datë 27.05.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkon informacion, ju bëjmë me dije se:

Për sa i përket aksit rrugor “Ura e Bardhajve – Mes”, punimet e së cilës kanë përfunduar në vitin 2015, Bashkia Shkodër disa herë ka kërkuar marrjen në dorëzim dhe kalimin në inventarin e saj të këtij aksi. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ky aks vazhdon të jetë në inventar të ARRSH dhe nuk është ndërmarrë asnjë procedurë, nga ana e ARRSH, për kalimin e këtij aksi në varësi të Bashkisë Shkodër.

Pengesa kryesore për kalimin e aksit rrugor “Ura e Bardhajve – Mes” ka të bëjë me gjendjen jo funksionale të sistemit të ndriçimit, dhe si pasojë pamundësia për të marrë në dorëzim një sistem ndriçimi jofunksional.

Presim nga ana e ARRSH kthimin në gjendjen optimale të këtij aksi dhe pastaj kalimin e tij në inventarin e Bashkisë Shkodër.

Po ashtu për sa i përket mirëmbajtjes së rrugës Bashkia Shkodër nuk ka kontraktuar me ndonjë sipërmarrës për arsyet që u përmendën më lart.

Për vënien në dispozicion të projektit të restaurimit të Urës së Mesit, duhet ti drejtoheni Drejtorisë Rajonale të Kulturës Shkodër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Voltana ADEMI